



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 21 (827977)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 29 maj 2026



Qeveria miraton tre vendime kyçe për forcimin e mbrojtjes, angazhimeve në NATO dhe menaxhimin e emergjencave civile »

faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI MERR PJESË NË PËRMBYLLJEN E STËRVITJES SHUMËKOMBËSHE "EFES-2026", NË TURQI

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralletenant Arben Kingji, mori pjesë në aktivitetin "Dita e Vizitorëve të Shquar", organizuar në Izmir të Turqisë, në përmblyllje të stërvitjes shumëkombëshe "EFES-2026", zhvilluar nga Forcat e Armatosura Turke me pjesëmarrjen e vendeve aleate dhe partnere. Në qendër të kësaj stërvitjeje ishte bashkëpunimi...

faqe 3



MINISTRI NUFI: AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA VIJON MISIONIN E SAJ NË FORMIMIN E OFICERËVE TË SË ARDHMES

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia zyrtare e dorëzimit të komandës së institucionit më të lartë të arsimit ushtarak në vend, ku gjeneralmajor Ferdinand Dimo mori detyrën e komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura, pas përfundimit të mandatit të gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj. Në ceremoninë solemne morën...

faqe 4



"GJENERALI I PAVARËSISË" ALI SHEFQETI (SHKUPI), STRATEGU I SHTETIT DHE USHTARISË SHQIPTARE

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në historinë e shtetit shqiptar dhe të Forcave tona të Armatosura, pak figura mbartin peshën, vizionin dhe sakrificën e major Ali Shefqeti Shkupi, ushtarakut të talentuar, patriotit...

faqe 6



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi mirëpriti homologun grek Nikos Dendias: Shqipëria dhe Greqia riafirmojnë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, priti në një vizitë zyrtare homologun e tij, ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, z. Nikos Dendias. Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe në vijimin e dialogut strategjik mes dy vendeve aleate në NATO.

Gjatë bisedimeve, ministri Nufi vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Greqisë për integrimin evropian të Shqipërisë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si një prioritet strategjik i përbashkët për të dy vendet.

“Objektivi kryesor i Shqipërisë në rajon mbetet avancimi i stabilitetit politik, sigurisë dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm”, - u shpreh ministri Nufi gjatë takimit. Ai theksoi se Shqipëria vijon të kontribuojë aktivisht në misionet ndërkombëtare të sigurisë, përmes pjesëmarrjes së personelit shqiptar në misionin EUFOR ALTHEA në Bosnjë-Hercegovinë dhe në KFOR në Kosovë.

Në fokus të diskutimeve ishte edhe bashkëpunimi detar ndërmjet dy vendeve. Ministri Nufi vlerësoi koordinimindhendërveprueshmërinë mes forcave detare shqiptare dhe greke, veçanërisht në kuadër të operacioneve të NATO-s në Detin Egje dhe Mesdhe, përfshirë operacionin “Sea Guardian”.

Sipas tij, Shqipëria po ndërmerr aktualisht hapa konkretë për forcimin dhe modernizimin e flotës detare, çka do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë detare dhe të pranisë së Aleancës në rajonin Adriatiko-Jonian.

Ministri i Mbrojtjes vlerësoi gj-



thashtu nivelin e bashkëpunimit ndërmjet personelit ushtarak të dy vendeve përmes aktiviteteve të përbashkëta, programeve të edukimit ushtarak, trajnimeve dhe shkëmbimit të ekspertizës profesionale.

Një vëmendje e veçantë gjatë takimit iu kushtua edhe riaktivizimit të protokollit teknik për bashkëpunimin ushtarak mjekësor ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë.

“Besojmë se duhet të synojmë riaktivizimin e këtij kuadri, veçanërisht në fushat e kujdesit shëndetësor të specializuar, trajnimit mjekësor dhe shkëmbimeve profesionale, në frymën e përfitimit të ndërsjellë dhe partneritetit strategjik”, - deklaroi ministri Nufi.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, z. Nikos Dendias, vlerësoi marrëdhëniet e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe rëndësinë e koordinimit të ngushtë në përballimin e sfidave të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Të dy ministrat ndanë të njëjtin qëndrim mbi nevojën për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe zhvillimin e bashkëpunimit ushtarako-industrial, duke i konsideruar ato prioritete të rëndësishme për Aleancën, në përputhje me dinamikat e reja të sigurisë dhe vendimet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Takimi konfirmoi vullnetin e përbashkët të Shqipërisë dhe Greqisë për të forcuar më tej partneritetin strategjik në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal, në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë kolektive.



Kalimi i komandës mes Kontingjenteve XVIII dhe XIX EOD në misionin e NATO-s në Letoni

Në Camp Adazi, Letoni, u zhvillua ceremonia zyrtare e kalimit të komandës dhe autoritetit ndërmjet Kontingjentit XVIII dhe Kontingjentit XIX EOD të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të angazhuar në kuadër të misionit të Forcës së Përparuar Tokësore të NATO-s.

Ceremonia u organizua në prani të përfaqësuesve të Brigadës Shumëkombëshe Letoneze, personelit ushtarak të vendeve aleate dhe efektivëve pjesëmarrës në mision.

Gjatë aktivitetit u vlerësua puna dhe angazhimi i Kontingjentit XVIII EOD, i cili përbushi me profesionalizëm dhe përkushtim detyrat operationale në funksion të sigurisë kolektive dhe mbështetjes së misionit të NATO-s në krahun lindor të Aleancës.

Përfaqësuesit e strukturave drejtuese të misionit shprehën mirënjohjen për kontributin e efektivëve shqiptarë, duke vënë në dukje nivelin e lartë të gatishmërisë, disiplinës dhe ndërveprueshmërisë së treguar gjatë gjithë periudhës së dislokimit.

Në vijim të ceremonisë, Kontingjenti XIX EOD mori zyrtarisht detyrën dhe autoritetin për vijimin e misionit, duke marrë përgjegjësinë për realizimin e detyrave operationale në kuadër të forcave shumëkombëshe të NATO-s në Letoni.

Efektivët e kontingjentit të ri do të vijnë të kontribuojnë në operacionet që lidhen me neutralizimin e mjeteve shpërthyes dhe garantimin e sigurisë në zonën e përgjegjësisë, në përputhje me standardet dhe angazhimet e Aleancës.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura shqiptare në këtë mision përbën një kontribut të rëndësishëm të Shqipërisë në forcimin e sigurisë kolektive dhe dëshmon angazhimin e vendit tonë si aleat i besueshëm në kuadër të NATO-s.

Shqipëria renditet e para në stërvitjen ndërkombëtare të NATO-s, “Guardian Purple 2026 – Drones & 5G”

Shqipëria ka arritur një sukses të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes dhe teknologjisë, duke u renditur në vendin e parë në stërvitjen ndërkombëtare “Guardian Purple 2026 – Drones & 5G” (GP26-DRONES), zhvilluar në kuadër të NATO-s.

Në këtë aktivitet morën pjesë 11 ekiye nga vende të ndryshme aleate dhe partnere, me fokus në integrimin e teknologjive të avancuara të dronëve dhe rrjeteve 5G në operacionet moderne ushtarake dhe të sigurisë.

Ekipi shqiptar, i përfaqësuar nga Komanda Kibernetike dhe Ndërlidhjes, u vlerësua për profesionalizmin, bashkëpunimin efektiv dhe performancën e lartë në një mjedis kompleks operacional, duke lënë pas ekipet pjesëmarrëse nga vendet e tjera.

Ky rezultat konsiderohet një dëshmi e nivelit të lartë të përgatitjes, disiplinës dhe aftësive teknike të personelit shqiptar në fushën e mbrojtjes kibernetike dhe teknologjive inovative.

Një falënderim i veçantë iu drejtua edhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për mbështetjen dhe kontributin e dhënë gjatë përgatitjes dhe realizimit të këtij suksesi.

Renditja e Shqipërisë në krye të kësaj stërvitjeje ndërkombëtare përforcon rolin dhe besueshmërinë e vendit në kuadër të aleancës së NATO-s, si dhe demonstroi kapacitetet në rritje në fushën e teknologjisë dhe sigurisë moderne.





Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e datës 28 maj 2026 tre vendime të rëndësishme që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe sistemin e mbrojtjes civile në vend. Vendimet u bënë publike nga ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, gjatë një konference për shtyp pas mbledhjes së qeverisë.

Vendimi i parë lidhet me zgjatjen e misionit shqiptar në Republikën e Letonisë deri më 31 dhjetor 2029. Shqipëria vijon të kontribuojë në kuadër të misioneve të NATO-s me një togë të specializuar EOD të Forcave të Armatosura, e angazhuar në operacionet e çminimit dhe neutralizimit të mjeteve shpërthyes.

Ministri Nufi vlerësoi profesionalizmin dhe angazhimin e efektiveve shqiptarë në këtë mision, duke theksuar se zgjatja e mandatit përforcon rolin e Shqipërisë në sigurinë kolektive të Aleancës Veri-Atlantike.

“Kemi një togë të dislokuar në territorin e Letonisë dhe do të zgjatet qëndrimi deri më 31 dhjetor 2029. Ky vendim shërben për konsolidimin e Forcave të Armatosura, sidomos në misionet e tyre në kuadër të NATO-s dhe konkretisht në Letoni”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e njësive EOD, e cila operon në funksion të çminimit të zonave të minuara dhe garantimit të sigurisë operationale në kuadër të misionit.

“Jemi krenarë për angazhimin e tyre. Besoj se kjo kohëzgjatje i shërben sigurisë së përbashkët kolektive në kuadër të NATO-s”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

Vendimi i dytë i miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhet me njësimin e gradave ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Sipas ministrit të Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, ky vendim synon harmonizimin e strukturës së gradave, në funksion të rritjes së koherencës organizative dhe standardizimit të sistemit ushtarak.

Ministri bëri të ditur se, pas ndryshimeve strukturore të ndërmarra ndër vite, veçanërisht pas vitit 2015, ishte shfaqur nevoja për disa përshtatje dhe harmonizime në sistemin e gradave ushtarake, të cilat tashmë adresohen përmes këtij vendimi të Këshillit të Ministrave.

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, ky hap kontribuon në konsolidimin e mëtejshëm të strukturave të Forcave të Armatosura, duke garantuar një sistem më të unifikuar dhe në përputhje me standardet organizative të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Ndërkohë, vendimi i tretë lidhet me miratimin e projekteve fituese të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Qeveria miraton tre vendime kyçe për forcimin e mbrojtjes, angazhimeve në NATO dhe menaxhimin e emergjencave civile



për vitin 2026, në funksion të përballimit të emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, lista përfshin 44 projekte në total, nga të cilat 26 janë projekte infrastrukturore, ndërsa 18 lidhen me blerjen e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për menaxhimin e emergjencave civile nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Vlera totale e financimit për projektet arrin në 650 milionë lekë për vitin 2026, ndërsa pjesa tjetër e financimit do të mbulohet gjatë vitit 2027.

“Të gjitha këto projekte do të zbatohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe do të veprojnë si autoritete kontraktore për prokurimin e shërbimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme”, - bëri të ditur ministri Nufi.

Ai theksoi se këto investime synojnë uljen e riskut nga fatkeqësitë natyrore, forcimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe garantimin e sigurisë për qytetarët.

Në përfundim të deklaratës së tij, ministri i Mbrojtjes

apeloj për vigjilencë të shtuar gjatë sezonit veror, për shkak të rrezikut të lartë nga zjarret në pyje dhe kullota.

“Do të bëja thirrje që me afimin e stinës së verës dhe temperaturave të larta të kemi një vëmendje të shtuar ndaj zonave të ndjeshme, sidomos pyjeve dhe kullotave. Ministria e Mbrojtjes ndërhyr në fazën e tretë të emergjencës, pas bashkive dhe prefekturave, përmes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Forcave të Armatosura”, - deklaroi ministri.

Ai u bëri thirrje qytetarëve dhe institucioneve vendore të tregojnë kujdes maksimal për mbrojtjen e territorit, me qëllim parandalimin e zjarrvënieve dhe dëmtimeve të mjedisit gjatë periudhës së verës.

Me këto vendime, qeveria synon të forcojë më tej kapacitetet operationale të Forcave të Armatosura, të përmirësojë sistemin e mbrojtjes civile dhe të rrisë gatishmërinë për përballimin e sfidave të sigurisë dhe emergjencave natyrore.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në aktivitetin “Dita e Vizitorëve të Shquar”, organizuar në Izmir të Turqisë, në përmbyllje të stërvitjes shumëkombëshe “EFES-2026”, zhvilluar nga Forcat e Armatosura Turke me pjesëmarrjen e vendeve aleate dhe partnere.

Në qendër të kësaj stërvitjeje ishte bashkëpunimi operacional dhe ndërveprueshmëria mes forcave ushtarake të vendeve pjesëmarrëse, ndërsa Forcat e Armatosura Shqiptare u përfaqësuan nga 70 efektivë të Forcës Tokësore.

Përgjatë një periudhe njëmuajore, trupat shqiptare zhvilluan stërvitje taktike dhe manovra komplekse, duke demonstruar profesionalizëm, përgatitje të lartë dhe përkushtim në realizimin e detyrave të ngarkuara.

Gjatë takimit me efektivat shqiptarë pas ekzekutimit të stërvitjes, gjenerallejtënant Arben Kingji shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin për performancën e tyre, duke i përgëzuar për përfaqësimin dinjitoz të Forcave të Armatosura të Shqipërisë përkrah vendeve aleate dhe partnere. Në kuadër të vizitës në Turqi, gjeneral Kingji zhvilloi edhe një takim me ekuipazhin e anijes “Oriku” të Forcës Detare, e cila aktualisht ndodhet në mision të NATO-s në ujërat e Detit Egje.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vlerësoi kontributin, sakrificën dhe profesionalizmin e personelit të anijes në përmbushjen me sukses të detyrave operationale në kuadër të Aleancës, duke theksuar rëndësinë e rolit të Shqipërisë në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal e ndërkombëtar.

Pjesëmarrja e gjenerallejtënant Arben Kingjit në këtë aktivitet shumëkombësh dhe takimet me trupat shqiptare në terren riafirmojnë angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për forcimin e bashkëpunimit me aleatët, rritjen e kapaciteteve operationale dhe kontributin aktiv në misionet e NATO-s.

Gjenerallejtënant Arben Kingji merr pjesë në përmbylljen e stërvitjes shumëkombëshe “EFES-2026”, në Turqi



Ministri Nufi: Akademia e Forcave të Armatosura vijon misionin e saj në formimin e oficerëve të së ardhmes

Gjeneralmajor Ferdinand Dimo merr drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia zyrtare e dorëzimit të komandës së institucionit më të lartë të arsimit ushtarak në vend, ku gjeneralmajor Ferdinand Dimo mori detyrën e komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura, pas përfundimit të mandatit të gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj.

Në ceremoninë solemne morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, gjeneralë, oficerë të lartë, pedagogë, studentë si dhe të ftuar të tjerë.

Ceremonia nisi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar dhe leximin e urdhrave përkatës për transferimin e detyrës. Më pas, në një moment simbolik dhe tradicional ushtarak, u bë dorëzimi i flamurit të komandës, duke shënuar zyrtarisht kalimin e drejtimit të Akademisë së Forcave të Armatosura te gjeneralmajor Ferdinand Dimo.

Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj falënderoi stafin akademik dhe ushtarak për bashkëpunimin gjatë periudhës së drejtimit të Akademisë, duke vlerësuar përkushtimin dhe punën e bërë në funksion të forcimit të institucionit. Ndërkohë, komandanti i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, shprehu angazhimin për të vijuar procesin e modernizimit dhe konsolidimit të institucionit, në përputhje me standardet e NATO-s dhe sfidat bashkëkohore të arsimit ushtarak. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, vlerësoi kontributin e gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj në drejtimin e Akademisë, duke theksuar progresin e arritur në konsolidimin akademik, fuqizimin e kërkimit shkencor dhe avancimin e projekteve infrastrukturore.

Ministri Nufi u ndal veçanërisht te akreditimi institucional i Akademisë gjatë vitit të kaluar, duke e cilësuar atë si një arritje të rëndësishme për sistemin e arsimit ushtarak shqiptar.

Sipas tij, ky proces dëshmoi seriozitetin, standardet dhe cilësinë e punës së realizuar nga drejtuesit dhe stafi akademik i institucionit.

Ai nënvizoi gjithashtu progresin e bërë për ndërtimin e kampusit të ri të Akademisë, i cili pritet të presë studentët në vitin e ardhshëm akademik.

“Ky është një investim strategjik për të ardhmen e arsimit ushtarak dhe për standardet që synojmë të arrijmë si vend anëtar i NATO-s”, - u shpreh ministri Nufi.

Duke uruar gjeneralmajor Ferdinand Dimon për detyrën e re, Ministri i Mbrojtjes theksoi se Akademia e Forcave të Armatosura ka një rol kyç në formimin profesional të oficerëve të rinj, zhvillimin e mendimit strategjik dhe forcimin e kulturës së sigurisë.

Sipas tij, Akademia duhet të shndërrohet gjithnjë e më shumë në një qendër moderne të arsimit dhe kërkimit shkencor, ku të formohen oficerët e së ardhmes, të aftë për



të komanduar dhe për t'u përballur me sfidat komplekse të sigurisë moderne. Ministri Nufi garantoj mbështetjen e plotë të Ministrisë së Mbrojtjes për vijimin e reformave dhe modernizimin e sistemit të arsimit ushtarak, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe partnerët euroatlantikë, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale

dhe ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura Shqiptare me standardet e NATO-s dhe Bashkimit European.

Ceremonia u mbyll me urimet për sukses në detyrën e re të gjeneralmajor Ferdinand Dimos dhe me angazhimin për vijimin e reformave në funksion të forcimit të arsimit ushtarak dhe përgatitjes së brezave të rinj të oficerëve shqiptarë.



Gjeneral Brigade Edmond Voci përfaqëson Shqipërinë në Komitetin e Aviacionit të NATO-s

Forca Ajrore Shqiptare, pjesë e forumit ndërkombëtar të aviacionit ushtarak të NATO-s

Në Lubjana të Sllovenisë u zhvillua takimi i radhës i Komitetit të Aviacionit të NATO-s, një forum i rëndësishëm i Aleancës Atlantike që mbledh drejtues dhe përfaqësues të aviacionit ushtarak nga vendet anëtare dhe partnere.

Në këtë aktivitet morën pjesë delegacione nga 35 vende aleate dhe partnere të NATO-s, ndërsa Shqipëria u përfaqësua nga Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Edmond Voci.

Gjatë punimeve të forumit, fokusi kryesor i diskutimeve ishte forcimi i sigurisë ajrore, përmirësimi i koordinimit të hapësirës ajrore dhe rritja e interoperabilitetit ndërmjet forcave ajrore të vendeve të Aleancës. Gjithashtu, pjesëmarrësit ndanë eksperiencat dhe praktikatat më të

mira në fushën e aviacionit ushtarak, me synim rritjen e kapaciteteve të përbashkëta operacionale.

Përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse diskutuan mbi sfidat aktuale të sigurisë, zhvillimet teknologjike dhe rëndësinë e bashkëpunimit të koordinuar në përballimin e kërcënimeve moderne në hapësirën ajrore.

Për Forcën Ajrore Shqiptare, pjesëmarrja në këtë forum përbën një mundësi të rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit me aleatët, shkëmbimin e eksperiencave profesionale dhe rritjen e mëtejshme të kapaciteteve operacionale dhe ndërveprueshmërisë në kuadër të NATO-s. Angazhimi aktiv i Shqipërisë në strukturat dhe forumet e Aleancës Atlantike dëshmon përkushtimin e vendit tonë në forcimin e sigurisë kolektive dhe modernizimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura.



Qendra e Gjuhëve të Huaja pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë shënoi 30-vjetorin e krijimit të saj, në një ceremoni përkujtimore ku morën pjesë drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes, pedagogë, oficerë, studentë dhe të ftuar të tjerë.

Në këtë aktivitet jubilar ishte e pranishme edhe zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana, e cila vlerësoi kontributin e kësaj qendre në përgatitjen profesionale të personelit ushtarak dhe civil të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Në fjalën e saj përshëndetëse, zëvendësministria Skana e cilësoi përvjetorin si një moment të rëndësishëm reflektimi mbi rrugëtimin dhe rolin strategjik që ka pasur Qendra e Gjuhëve të Huaja gjatë tre dekadave të fundit.

“Në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, gjuha nuk është thjesht një mjet për shkëmbimin e informacionit. Ajo është një urë lidhëse, thelbi i diplomacisë ushtarake dhe një aset strategjik që garanton bashkëpunimin”, - u shpreh zëvendësministria e Mbrojtjes.

Sipas saj, gjatë këtyre 30 viteve, Qendra e Gjuhëve të Huaja ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen e oficerëve dhe drejtuesve që kanë përfaqësuar Shqipërinë



dhe Forcat e Armatosura në misione ndërkombëtare, në strukturat e NATO-s dhe në forume të rëndësishme të sigurisë globale.

Zëvendësministria Skana theksoi se në operacionet moderne ushtarake dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar,



Qendra e Gjuhëve të Huaja feston 30-vjetorin, zëvendësministria Skana: Gjuha është aset strategjik për sigurinë dhe bashkëpunimin



suksesi nuk varet vetëm nga përgatitja taktike apo kapacitetet operacionale, por edhe nga komunikimi efektiv, ndërtimi i besimit dhe aftësia për të bashkëpunuar përmes gjuhës. Ajo shprehu gjithashtu mirënjohjen për pedagogët, instruktorët dhe stafin akademik që kanë kontribuar ndër vite në rritjen dhe konsolidimin e kësaj qendre si një institucion i rëndësishëm

në sistemin e arsimit ushtarak shqiptar.

Qendra e Gjuhëve të Huaja pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë ka si mision kryesor aftësimin gjuhësor të personelit ushtarak dhe civil për t’iu përgjigjur standardeve të NATO-s dhe kërkesave të operacioneve ndërkombëtare.

Kjo qendër planifikon dhe zhvillon programe të specializuara në fushën e mësimdhënies, testimit dhe përkthimit të gjuhëve të huaja, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të Forcave të Armatosura si vend anëtar i Aleancës Veri-Atlantike.

Njëkohësisht, Qendra e Gjuhëve të Huaja ka zgjeruar ndër vite bashkëpunimin me institucione homologe të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s, me synim shkëmbimin e eksperiencave dhe implementimin e metodave më bashkëkohore të mësimdhënies dhe komunikimit profesional.

30-vjetori i kësaj qendre u vlerësua si një moment jo vetëm për të kujtuar rrugëtimin e deritanishëm, por edhe për të riafirmuar rëndësinë që ka përgatitja gjuhësore në përballimin e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes në një mjedis gjithnjë e më kompleks ndërkombëtar.

KLSM përmbyll me sukses edicionin XVI pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë

Shqipëria konsolidon rolin si qendër rajonale e edukimit strategjik në siguri dhe mbrojtje

Ushtarakë të lartë të Forcave të Armatosura shqiptare, përfaqësues nga vendet e NATO-s dhe profesionistë civilë të fushës së sigurisë, përfunduan me sukses Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), zhvilluar pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Ceremonia e diplomimit u zhvillua në praninë e drejtuesve të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura. Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Blerina Abrazhda, zëvendësministria znj. Pranvera Skana, zëvendësministri z. Enkelejdi Joti, si dhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Raziye Mehmeti. Të pranishëm ishin gjithashtu komandantë forcash, ambasadorë, atashe ushtarakë të vendeve të NATO-s, familjarë të kursantëve dhe të ftuar të tjerë. Në fjalën e saj përshëndetëse, zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, vlerësoi rëndësinë e marrëdhënieve profesionale dhe personale të krijuara gjatë zhvillimit të kursit, duke theksuar se ato përbëjnë një bazë të rëndësishme për ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet pjesëmarrësve.

“Gjatë këtyre muajve, Shqipëria u bë një pikë takimi ku oficerë dhe profesionistë nga e gjithë Evropa dhe Lindja e Mesme u ulën bashkë, punuan bashkë dhe mësuan nga njëri-tjetri. Kjo larmi nuk ishte pengesë. Ishte forcë. Stabiliteti në fund të fundit varet nga profesionistë të disiplinuar. Njerëz që e kuptojnë se lidhshipi nuk ka të bëjë me vizibilitetin, por me përgjegjësinë”, - u shpreh znj. Abrazhda. Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes, i themeluar në standardin aktual me mbështetjen e “George C. Marshall European Center for Security Studies”, përfshin pjesëmarrës ushtarakë dhe civilë nga Shqipëria, vendet e rajonit, NATO dhe shtete partnere.

Që prej vitit 2012, KLSM mban statusin



“NATO Listed Course”, duke u kthyer në një nga platformat më të rëndësishme për formimin e drejtuesve strategjikë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Programi tre mujor i kursit ofron njohuri të avancuara mbi mjedisin global të sigurisë, organizatat ndërkombëtare, NATO-n, leadershipin dhe komunikimin strategjik. Leksionet zhvillohen nga ekspertë të njohur vendas dhe ndërkombëtarë, përfaqësues diplomatikë dhe drejtues institucionesh të sigurisë.

Në Kursin e Lartë XVI të Sigurisë dhe Mbrojtjes, i cili konsiderohet forumi më i lartë në piramidën e arsimit ushtarak në vend, për herë të parë morën pjesë edhe kolonellë nga Forcat e Armatosura të Jordanisë dhe Polonisë, duke zgjeruar më tej dimensionin ndërkombëtar të këtij programi prestigjioz.



IN MEMORIAM

**Lamtumirë
“Malsorit të
Detit”: Shuhet
Komandant
Skënder Doçi,
patrioti që iu
përgjigj thirrjes
së kombit deri
në fund**



U nda nga jeta një nga figurat e respektuara të detarisë shqiptare dhe të çështjes kombëtare, Komandant Skënder Doçi, i njohur me respekt si “Malsori i Detit”.

Ish-komandanti i Flotës Detare Shqiptare, mbetet në kujtesën e bashkëluftëtarëve dhe të gjithë atyre që e njohën si një burrë me integritet, disiplinë dhe përkushtim të rrallë ndaj atdheut. Edhe në moshën 64-vjeçare, në një nga periudhat më të vështira për kombin shqiptar, Komandant Doçi iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si komandant i Batalionit “Atlantiku” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me eksperiencën ushtarake, autoritetin moral dhe shpirtin e tij patriotik, ai organizoi, trajnoi dhe frymëzoi dhjetëra vullnetarë shqiptarë që iu përgjigjën thirrjes së lirisë për Kosovën. Ai nuk ishte vetëm një komandant. Ishte simbol i përgjegjësisë kombëtare, i sakrificës dhe i besimit se liria dhe dinjteti mbrohen me përkushtim dhe ideal. Figura e tij do të kujtohet me nderim si një ushtarak profesionist, patriot i devotshëm dhe mentor për brezat që besojnë tek vlerat e shërbimit ndaj kombit. Ikja e Komandant Skënder Doçit është humbje për familjen, bashkëluftëtarët dhe gjithë ata që vlerësojnë kontributin e njerëzve që i shërbyen Shqipërisë dhe çështjes kombëtare me dinjteti.

**Pushhofsh në paqe, Komandant!
Lavdi kujtimit dhe veprës suaj!**

Redaksia e Shtypit Ushtarak

“Gjenerali i Pavarësisë” Ali Shefqeti (Shkupi), strategu i shtetit dhe ushtrisë shqiptare

“Babai im jetoi vetëm për Shqipërinë” - Një jetë për Shqipërinë, rrëfimi i Skënder Shkupit për të atin



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në historinë e shtetit shqiptar dhe të Forcave tona të Armatosura, pak figura mbartin peshën, vizionin dhe sakrificën e major Ali Shefqeti Shkupit, ushtarakut të talentuar, patriotit të vendosur dhe organizatorit të parë të Shtabit Madhor të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Në fund të prillit të vitit 1913, ndërsa Shqipëria e sapo shpallur e pavarur përballë me rreziqe të mëdha për ekzistencën e saj, në brigjet e Vlorës mbërrinte një 30-vjeçar me formim të shkëlqyer ushtarak dhe me ideale të qarta kombëtare. Ishte Ali Shefqeti, i lindur në Shkup më 1883, bir i patriotit Hysen Shefqeti nga Peja dhe i një familjeje të njohur shqiptare të Shkupit.

I diplomuar me rezultate të shkëlqyera në shkollat ushtarake të Selanikut, Manastirit dhe më pas në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Stamboll, ku studioi së bashku me Mustafa Qemal Ataturkun, ai u formua si një ndër oficerët më të përgatitur shqiptarë të kohës. Pas shërbimeve të rëndësishme në Armatën III osmane dhe pjesëmarrjes në lëvizjen xhonturke, Ali Shefqeti do të afrohej gjithnjë e më shumë me rrethet patriotike shqiptare, duke u kthyer në një nga mbështetësit aktivë të çështjes kombëtare.

Pas arratisjes nga Stambolli në vitin 1912, për shkak të qëndrimeve të tij politike dhe patriotike, ai mori pjesë në Kongresin e Triestes dhe më pas, duke sfiduar bllokadën greke ndaj Vlorës, mbërriti në Shqipëri për t'iu bashkuar Qeverisë së Ismail Qemalit.

Menjëherë, për shkak të autoritetit dhe profesionalizmit që gëzonte, iu besua detyra e organizimit të Ministrisë së Luftës dhe krijimit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Kombëtare. Nën drejtimin e tij u hartuan rregulloret e para ushtarake, nisi organizimi i ushtrisë së rregullt shqiptare, u hodhën bazat e shërbimit ushtarak dhe u krijuan strukturat moderne të administrimit ushtarak. Madje, që në vitin 1913, ai angazhoi një komision të posaçëm për terminologjinë ushtarake shqipe, një dëshmi e qartë e vizionit të tij për një ushtri moderne dhe kombëtare.

Veprimtaria e Ali Shefqetit nuk u ndal me kaq. Ai mbeti një figurë kyçe në organizimin e ushtrisë shqiptare edhe pas largimit të Qeverisë së Vlorës, mbështeti Kongresin e Lushnjës, drejtoi struktura të larta ushtarake dhe u përfshi aktivisht në zhvillimet politike e demokratike të vendit. Për bindjet e tij politike dhe kundërshtimin ndaj regjimit zogist, ai njohu burgun, internimet dhe madje u dënua edhe me vdekje në vitin 1935, dënim që nuk u ekzekutua për shkak të reagimeve të forta publike.

Edhe gjatë pushtimit fashist dhe nazist ai mbeti i palëkundur në qëndrimet e tij patriotike. Shtëpia iu dogj nga



nazistët gjermanë, ndërsa vitet e fundit të jetës i kaloi në Shkodër, larg vëmendjes që meritonte një prej themeluesve të ushtrisë moderne shqiptare.

Sot, duke kujtuar jetën dhe veprën e Ali Shefqeti Shkupit, kujtojmë jo vetëm një ushtarak të shquar, por një nga arkitektët e shtetit shqiptar modern.

Për të folur më gjerësisht mbi figurën, kontributin historik dhe trashëgiminë që Ali Shefqet Shkupi la në historinë kombëtare shqiptare, zhvillojmë këtë intervistë me birin e tij, z. Skënder Shkupi.

Z. Skënder Shkupi është një personalitet i njohur i jetës akademike dhe diplomatike shqiptare. Ai ka shërbyer për shumë vite si pedagog i fizikës dhe astronomisë në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, ka drejtuar revistën “Shkenca dhe Jeta”, ka qenë aktiv në lëvizjet demokratike të viteve '90, deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe më pas ambasador i Shqipërisë në Ankara. Përvoja e tij shumëdimensionale në arsim, diplomaci dhe jetën publike e bën këtë bisedë jo vetëm një rrëfim familjar për Ali Shefqet Shkupin, por edhe një dëshmi të vyer për një periudhë të rëndësishme të historisë shqiptare.

Në këtë intervistë, z. Skënder Shkupi ndalet jo vetëm te figura e të atit, patriotit dhe organizatorit të parë të Shtabit

Madhor të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, por edhe te përvojat e tij personale si pedagog në shkollën legjendare “Skënderbej”, marrëdhëniet me kolegët, jeta akademike, publicistika shkencore dhe reflektimet mbi rolin që duhet të ketë sot edukimi ushtarak në Shqipëri.

Zoti Skënder, kush ishte Ali Shefqeti (Shkupi) në jetën familjare dhe si e kujtoni ju figurën e tij?

Për mua ai ishte para së gjithash një njeri me karakter të jashtëzakonshëm. Ishte i qetë në komunikim, shumë i disiplinuar dhe tepër i drejtë. Nuk fliste shumë për veten, por çdo veprim i tij tregonte përgjegjësi dhe dashuri të thellë për Shqipërinë.


Ai e konsideronte jetën e tij si shërbim ndaj kombit. Nuk e ndante asnjëherë detyrën ushtarake nga misioni patriotik. Për të, ushtria shqiptare nuk ishte vetëm një forcë mbrojtëse; ishte shtylla e shtetit shqiptar.

Edhe në familje ruante të njëjtën disiplinë morale. Na mësonte gjithmonë se nderi, fjala e dhënë dhe përgjegjësia janë pasuria më e madhe e njeriut.

“Ai ishte ndër ushtarakët më të arsimuar shqiptarë të kohës”



Skënder Shkupi



Si nisi rruga e tij drejt formimit ushtarak?

Babai lindi në Shkup, në shtator të vitit 1883, në një familje me tradita patriotike. Gjyshi im, Hysen Shefqeti, ishte nga Peja dhe njihej për ndjenjat e forta kombëtare.

Që i ri tregoi aftësi të jashtëzakonshme në mësimet. Kreu shkollën qytetëse në Selanik dhe më pas gjimnazin ushtarak të Manastirit, ku u dallua ndër studentët më të mirë.

Më vonë vazhdoi studimet në Stamboll në shkollën e lartë ushtarake “Harp Okulu” dhe më pas në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm.

Duhet kuptuar se në atë kohë Akademia e Shtabit ishte ndër institucionet më elitare ushtarake të Perandorisë Osmane. Vetëm oficerët më të talentuar arrinin të diplomoheshin aty.

Babai e përfundoi Akademinë në vitin 1905 bashkë me Mustafa Qemalin, që më vonë u bë Ataturku. Kjo tregon nivelin e lartë profesional që kishte.

“Ai e kuptoi shpejt se shqiptarët duhej të kishin shtetin e tyre”

Çfarë raporti kishte ai me lëvizjen xhonturke dhe me patriotët shqiptarë?

Në fillim, si shumë intelektualë dhe ushtarakë të kohës, ai besoi se lëvizja xhonturke do të sillte reforma dhe barazi për kombet e Perandorisë Osmane. Madje mori pjesë edhe në lëvizjen kundër regjimit absolutist të sulltanit.

Por shumë shpejt kuptoi se shqiptarët nuk do të kishin të drejtat e tyre kombëtare brenda Perandorisë. Kjo e afroi edhe më shumë me patriotët shqiptarë në Selanik, Manastir dhe Stamboll.

Ai filloi të punonte në heshtje për çështjen shqiptare, duke ndihmuar lidhjet mes patriotëve dhe duke mbështetur organizimin kombëtar.

Pas kryengritjes shqiptare të vitit 1912, autoritetet osmane vendosën ta arrestonin. Ishte moment shumë i rrezikshëm për të.

Me ndihmën e patriotëve shqiptarë arriti të largohej nga Stambolli drejt Rumanisë dhe më pas në Trieste.

“Në Vlorë mbërriti si ushtarak, por u prit si shpresë kombëtare”

Si erdhi ai në Shqipëri dhe si nisi misioni i tij në shtetin shqiptar?

Babai kishte dëshirë të shkonte menjëherë pranë Qeverisë së Ismail Qemalit në Vlorë, por situata ishte shumë e vështirë, sepse flota greke kishte bllokuar zonën.

Vetëm në fund të prillit 1913 arriti të zbarkonte nga një anije austro-hungareze në grykën e Semanit dhe më pas shkoi në Vlorë.

Kur mbërriti, Shqipëria ishte ende shtet në lindje. Kishte entuziazëm patriotik, por mungonin strukturat shtetërore dhe sidomos organizimi ushtarak.

Qeveria e Ismail Qemalit e kuptoi menjëherë vlerën e tij dhe e ngarkoi me organizimin e Ministrisë së Luftës. Babai e konsideronte këtë detyrë si mision historik.

“Krijimi i Shtabit Madhor ishte lindja reale e ushtrisë shqiptare”

Çfarë rëndësie kishte krijimi i Shtabit Madhor?

Shumë njerëz nuk e kuptojnë sa i madh ishte ai hap për Shqipërinë.

Në atë kohë vendi ishte i rrethuar nga rreziqe. Kishte pushtime, mungesë administrate dhe mungesë financash.

Megjithatë, babai këmbënguli që ushtria shqiptare të ndërtohej sipas standardeve europiane.

Më 5 maj 1913, u miratua Rregullorja e Ministrisë së Luftës dhe aty u krijua zyrtarisht Shtabi Madhor.

Babai u emërua Kryetari i parë i tij. Ai punonte ditë e natë për organizimin e strukturave ushtarake, për hartimin e rregulloreve dhe për krijimin e bazës ligjore të ushtrisë.

Besonte se ushtria duhej të ishte institucion kombëtar dhe jo forcë krahinore.

“Ai nuk ndërtoi vetëm ushtri, por edhe kulturë ushtarake shqiptare”

Përveç organizimit ushtarak, cilat ishin prioritetet e tij?

Babai mendonte shumë larg për kohën. Ai nuk kërkonte vetëm armë dhe ushtarë. Kërkonte edhe dije ushtarake. Për këtë arsye porosi libra ushtarakë, dokumentacion administrativ dhe materiale profesionale nga jashtë vendit.

Një nga punët më të rëndësishme ishte ngritja e komisionit për terminologjinë ushtarake shqiptare.

Ai donte që ushtria shqiptare të fliste shqip edhe në konceptet profesionale.

Komisioni ku bënëin pjesë Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejдини krijoi shumë nga termat që përdoren edhe sot.

Babai besonte se kultura ushtarake është pjesë e pavarësisë kombëtare.

“Ai ishte gjithmonë në vijën e parë të interesit kombëtar”

Si vijoi jeta e tij pas largimit të Ismail Qemalit?

Babai vazhdoi të shërbente në poste të larta ushtarake edhe pas rënies së Qeverisë së Vlorës.

Gjatë Luftës së Parë Botërore u arrestua nga forcat malazeze në Shkodër dhe qëndroi në burg deri në vitin 1916.

Më pas mbështeti fuqishëm Kongresin e Lushnjës dhe qeveria e dalë prej tij e emëroi komandant të Komandës së Përgjithshme dhe më vonë përsëri Shef të Shtabit Madhor.

Ai ishte shumë i lidhur me Hasan Prishtinën dhe me forcat demokratike shqiptare.

Në Lëvizjen e Qershorit, 1924 pati rol aktiv dhe mori përsëri detyra të rëndësishme në ushtri.

“Regjimi e dënoi me vdekje, por nuk e mposhti dot”

Çfarë ndodhi me të gjatë periudhës së Mbretërisë?

Regjimi i Zogut e shihte si kundërshtar politik dhe si figurë me ndikim të madh në ushtri.

Ai u internua disa herë dhe në vitin 1935 u dënua me vdekje si organizator i një lëvizjeje për rrëzimin e regjimit.

Por reagimet e forta brenda dhe jashtë Shqipërisë e detyruan regjimin të tërhiqej nga ekzekutimi.

Ai doli nga burgu në vitin 1938. Megjithatë, asnjëherë nuk u thye shpirtërisht.

“Edhe në varfëri ruajti dinjitetin e tij”

Si i jetoi vitet e fundit të jetës?

Babai e kundërshtoi pushtimin fashist të Shqipërisë. Gjatë okupacionit nazist, gjermanët i dogjën shtëpinë në Tiranë.

Më pas jetuam në Shkodër në kushte të vështira ekonomike. Ai mernte një pension shumë të vogël.

Por edhe në ato kushte ruante krenarinë dhe dinjitetin. Nuk kërkoi privilegje dhe nuk u ankua kurrë.

Deri në fund të jetës mbeti i interesuar për fatet e Shqipërisë dhe ushtrisë shqiptare.

Vdiq më 3 dhjetor 1953.

“Historia shqiptare duhet ta vendosë në vendin që meriton”

Si mendoni se duhet kujtuar sot Ali Shefqeti (Shkupi)?

Mendoj se historia shqiptare ende nuk e ka vlerësuar sa duhet figurën e tij.

Ai ishte themeluesi profesional i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Ishte ushtarak me kulturë europiane, patriot i palë-kundur dhe drejtues me vizion modern.

Në kohën më të vështirë për Shqipërinë, ai ndërtoi themelet institucionale të ushtrisë sonë.

Babai nuk luftoi për poste apo lavdi personale. Luftoi për shtetin shqiptar.

Dhe kjo është arsyeja pse figura e tij duhet të studiohet dhe të nderohet më shumë nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm të ushtarakëve shqiptarë.

NAIM FRASHËRI, DRITA QË NDRIÇOI KOMBIN

Figura që zgjoi ndërgjegjen shqiptare dhe mbetet frymëzim për brezat

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka figura historike që mbeten në libra dhe ka figura që jetojnë në ndërgjegjen e një kombi. Naim Frashëri është një prej atyre emrave që nuk i përkasin vetëm historisë së Shqipërisë, por vetë shpirtit shqiptar.

Sot, kur kujtojmë lindjen e tij, më 25 maj 1846, në Frashër, kujtojmë jo vetëm poetin e madh të gjuhës shqipe, por një mendimtar, patriot dhe rilindas që i dha zë një populli të shtypur dhe i tregoi rrugën drejt vetëdijes kombëtare.

Në shekullin XIX, shqiptarët jetonin të shpërndarë, pa shtet, pa shkollë shqipe dhe pa institucione kombëtare. Ishte koha kur identiteti shqiptar rrezikonte të humbiste mes ndikimeve të huaja dhe sundimit osman. Pikërisht në këtë periudhë të errët, Naim Frashëri u bë drita që ndriçoi mendjen dhe zemrën e shqiptarëve.

Ai kuptoi një të vërtetë të madhe, një komb nuk mbijeton vetëm me armë, por me gjuhë, kulturë dhe ndërgjegje.

Dhe kështu, me penën e tij, nisi një nga betejat më të rëndësishme të historisë shqiptare, luftën për zgjimin kombëtar.

FORMIMI I NJË RILINDASI

Naim Frashëri u rrit në një familje me tradita patriotike dhe kulturore. Bashkë me vëllezërit e tij, Abdyl Frashëri dhe Sami Frashëri, ai do të bëhej pjesë e trinisë më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Studimet në gjimnazin “Zosimea” në Janinë i dhanë atij një kulturë të gjerë filozofike dhe letrare. Ai njohu mendimin oriental dhe atë perëndimor, mësoi disa gjuhë të huaja dhe krijoi një botëkuptim modern për kohën.

Por, ndryshe nga shumë intelektualë të epokës që zgjidhnin të integroheshin në strukturat e Perandorisë Osmane, Naimi zgjodhi një rrugë tjetër, t’ia kushtonte dijen dhe jetën kombit të tij.

Edhe pse punoi për vite në administratën osmane në Stamboll, zemra e tij mbeti gjithmonë tek Shqipëria.

Ai u përfshi aktivisht në lëvizjen kombëtare shqiptare, në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit



dhe në Shoqërinë e Stambollit, duke kontribuar në përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë kombëtare.

Në kohën kur shumë shqiptarë nuk kishin ende vetëdije kombëtare, Naim Frashëri po ndërtonte themelet shpirtërore të Shqipërisë moderne.

POETI QË I DHA SHQIPËRISË SHPIRT

Madhështia e Naim Frashërit nuk qëndron vetëm te patriotizmi i tij, por te mënyra si ai arriti ta shndërrojë dashurinë për atdheun në art.

Në veprën “Bagëti e Bujqësi”, ai i këndoi Shqipërisë me një ndjenjë të rrallë poetike.



Natyra shqiptare, jeta e fshatit, puna e njerëzve të thjeshtë dhe bukuria e vendit morën një dimension të ri në letërsinë shqipe.

Ai nuk përshkroi vetëm peizazhe. Ai ndërtoi identitet. Për herë të parë, shqiptarët panë veten në poezi.

Në “Lulet e Verës”, Naimi solli filozofi, humanizëm dhe reflektim mbi jetën, ndërsa në “Istori e Skënderbeut” ngriti figurën e Gjergj Kastrioti - Skënderbeu si simbol të unitetit dhe qëndresës shqiptare.

Në një kohë kur shqiptarët kishin nevojë për besim dhe frymëzim, Naimi ua dha përmes vargut.

***Ai nuk shkroi thjesht poezi.
Ai shkroi ndërgjegjen e një kombi.***

GJUHA SHQIPE SI ARMË KOMBËTARE

Kontributi i Naim Frashërit nuk kufizohet vetëm në letërsi.

Ai ishte një nga mbrojtësit më të mëdhenj të gjuhës shqipe dhe arsimit kombëtar. Në kohën kur mësimi i shqipes pengohej dhe shkollat shqipe ishin të pakta, Naimi hartoi libra shkollorë dhe ndihmoi në përhapjen e dijes në gjuhën amtare.

Ai e kuptonte se: pa gjuhë nuk ka komb.

Pikërisht për këtë arsye, vepra e tij kishte një mision më të madh sesa arti. Ajo kishte mision kombëtar.

Vargu: **“Ti Shqipëri, më jepnder,
më jep emrin shqipëtar”**
mbetet edhe sot një nga deklaratat më të fuqishme të identitetit shqiptar.

Në pak fjalë, Naim Frashëri përmbledhi gjithë dashurinë, krenarinë dhe sakrificën për atdheun.

Ai u mësoi shqiptarëve të mos turpëroheshin nga emri i tyre. Të mos harronin gjuhën e tyre. Të besonin tek e ardhmja e kombit.

**MESAZHI I NAIMIT
NË KOHËT MODERNE**

Edhe sot, më shumë se një shekull pas vdekjes së tij, mesazhi i Naim Frashërit mbetet aktual. Në një kohë globalizimi, emigrimi dhe sfidash identitare, figura e tij na kujton se një komb mbijeton vetëm kur ruan gjuhën, kulturën dhe kujtesën historike. Brezi i sotëm shqiptar jeton në një botë shumë më të hapur se ajo e Naimit, por sfidat mbeten të ngjashme, largimi nga rrënjët, harresa e gjuhës, dobësimi i identitetit kombëtar.

Prandaj vepra e Naim Frashërit nuk duhet parë vetëm si trashëgimi letrare, por si një udhërrëfyes moral dhe kombëtar për brezat. Për institucionet shtetërore, për arsimin, për ushtrinë dhe për çdo shqiptar, Naimi mbetet simbol i atdhedashurisë së ndershme dhe i përkushtimit ndaj kombit.

***Sepse ai na mësoi se dashuria për Shqipërinë nuk është slogan.
Është përgjegjësi.***

NJË DRITË QË NUK SHUHET

Naim Frashëri u nda nga jeta, më 20 tetor 1900, por vepra dhe mendimi i tij nuk u larguan kurrë nga shqiptarët. Ai mbetet një nga themelet më të forta të kulturës dhe identitetit tonë kombëtar. Në historinë shqiptare ka luftëtarë që mbrojtën vendin me armë, por ka edhe njerëz si Naim Frashëri që e mbrojtën kombin me mendim, dije dhe kulturë. Dhe ndoshta kjo është madhështia më e madhe e tij: ai fitoi zemrat e shqiptarëve pa përdorur forcën.

Sot, në çdo shkollë ku mësohet shqip, në çdo flamur kuqezi, në çdo varg që flet për Shqipërinë, jeton ende fryma e Naim Frashërit.

Sepse ai nuk ishte vetëm poet. Ai ishte

zëri i shpirtit shqiptar. Dhe ky zë nuk do të shuhet kurrë.

**NAIM FRASHËRI DHE FRYMA
KOMBËTARE E FORCAVE
TË ARMATOSURA**

Rëndësia e veprës së Naim Frashërit nuk qëndron vetëm në dimensionin letrar apo kulturor. Ajo lidhet ngushtë edhe me frymën patriotike dhe me vetë konceptin e mbrojtjes së identitetit kombëtar shqiptar, një mision që sot mishërohet edhe nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në thelb, Naim Frashëri ishte një luftëtar i kombit me armën e dijes dhe të fjalës. Në një kohë kur Shqipëria nuk kishte ushtri kombëtare dhe as shtet të pavarur, ai ndërtoi atë që çdo forcë e armatosur ka nevojë përpara çdo arme: ndërgjegjen kombëtare.

Sepse ushtria nuk mbron vetëm territorin. Ajo mbron historinë, identitetin, gjuhën dhe shpirtin e kombit. Dhe pikërisht këto vlera përçoi Naim Frashëri në gjithë krijimtarinë e tij.

Vargjet e tij për Shqipërinë, për gjuhën dhe për figurën e Gjergj Kastriotit – Skënderbeu, mbeten edhe sot burim frymëzimi për çdo ushtarak shqiptar që shërben nën flamurin kuqezi.

Në “Istori e Skënderbeut”, ai ngriti lart figurën e heroit kombëtar jo vetëm si prijës lufte, por si simbol të unitetit, sakrificës dhe mbrojtjes së atdheut. Këto janë po ato vlera mbi të cilat ndërtohet edhe misioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë: besnikëria ndaj kombit, mbrojtja e sovranitetit, sakrifica për vendin, nderi dhe përkushtimi ndaj flamurit.

Në një epokë moderne ku sfidat e sigurisë nuk janë vetëm ushtarake, por edhe kulturore e identitare, mesazhi i Naim Frashërit merr një rëndësi të veçantë. Ai na kujton se forca e një kombi nuk matet vetëm me armatim, por edhe me nivelin e ndërgjegjes kombëtare dhe me dashurinë për atdheun.


Prandaj, figura e Naimit mbetet aktuale edhe për brezat e rinj të ushtarakëve shqiptarë.

Ai u mëson se: atdheu nuk mbrohet vetëm në kufi, por edhe në gjuhë, në kulturë, në kujtesë historike, dhe në ruajtjen e identitetit kombëtar.

Vargu i tij: “Ti Shqipëri, më jep nder, më jep emrin shqipëtar” është më shumë sesa poezi. Është betim moral. Është thirrje patriotike. Është frymëzim për çdo shqiptar që i shërben vendit të tij.

Dhe pikërisht për këtë arsye, emri i Naim Frashërit mbetet i lidhur jo vetëm me letërsinë shqipe, por edhe me vetë frymën e shtetit shqiptar dhe institucionet që mbrojnë dinjitetin, lirinë dhe të ardhmen e kombit.

GJENERAL BRIGADE (REZ.) VLADIMIR QIRJAZI, nga bankat e shkollës “Skënderbej” drejt misioneve ndërkombëtare



NGA MAJOR (R) NEXHBEDIN BASHA

Bosnja, porta hyrëse e Shqipërisë drejt NATO-s

Rruga ushtarake e Gjeneral Brigade (rez.) Vladimir Qirjazi nisi herët, në vjeshtë të vitit 1973, kur ai hapi portën e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”, institucion që formoi breza të tërë oficerësh shqiptarë. Katër vitet e kaluara aty nuk ishin vetëm shkollim ushtarak, por një proces formimi karakteri, disipline dhe përgjegjësie. “Katër vite të ngjeshura më mësuan të jep vetvetja, të ec drejtë, të mos kthehesha mbrapa dhe të mos shmangesha kurrë nga përgjegjësia”, kujton ai.

Stazhi në Fierzë i dha kontaktin e parë me sakrificën reale të punës dhe organizimit, ndërsa studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe më pas eksperiencën në Brigadën e 3-të në Ersekë, i krijuan bindjen se komandimi nuk fitohet me zë të lartë, por me shembull.

Më 25 maj 1982, mori gradën e ‘nëntogerit’, duke nisur një karrierë që do ta çonte nga komandant kompanie e batalioni, deri në nivelet më të larta drejtuese të Forcave të Armatosura.

Pas përvojës në terren, ai vijoi Akademinë e Mbrojtjes dhe më pas u angazhua si pedagog dhe punonjës shkencor, duke kombinuar përvojën praktike me studimin ushtarak.

Gradimi si nënkolonel në dhjetor 1994 erdhi në një periudhë të vështirë për Shqipërinë, ndërsa detyrat e mëvonshme si zëvendëskomandant i Forcës Tokësore, komandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Zall-Herr, drejtues në Komandën e Mbështetjes dhe më pas në Komandën e Forcës së Bashkuar në Durrës, e kthyen atë në një nga drejtuesit me përvojë të ushtrisë shqiptare.

Në vitin 2008 u gradua ‘gjeneral brigade’ — një vlerësim që kurorëzoi dekada shërbimi, sakrifice dhe përkushtimi ndaj Forcave të Armatosura.

Gjeorgjia, përballja e parë me misionet ndërkombëtare

Përvoja e parë ndërkombëtare për Vladimir Qirjazin ishte misioni i vëzhguesve ushtarakë të OKB-së në Gjeorgji (UNMOIG), ku shërbeu nga 1 tetori 1994 deri më 15 prill 1995.

Ky mision ishte shumë më tepër sesa një angazhim operacional. Ishte kontakti i parë real me bashkëpunimin shumëkombësh, me menaxhimin e krizave dhe me standardet ndërkombëtare të paqeruajtjes. “Nuk kisha asnjë ide se si do të ishte bota atje, vetëm bindjen se Shqipëria duhej të kishte zërin e saj”, shprehet ai.

Përvoja në Gjeorgji u kthye në një shkollë praktike të diplomacisë ushtarake dhe të reagimit në situata të



ndërlikuara. Pa e ditur ende, ajo do ta përgatiste për një mision historik që do të vinte pak më vonë: Bosnje-Hercegovina.

Trajnimi në Gjermani, hapi drejt NATO-s

Në maj të vitit 1996, ndërsa përgatitjet e kompanisë paqeruajtëse shqiptare vazhdonin në Sauk, Vladimir Qirjazi u thirr në zyrën e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Armand Vinçani.

Vendimi ishte historik: një pjesë e kontingjentit shqiptar do t’i bashkohej forcave gjermane në Bosnjë-Hercegovinë dhe komandën e këtij kontingjenti do ta merrte ai.

Pas eksperiencës në OKB, ai kishte nisur punën për ngritjen e kompanisë së parë paqeruajtëse shqiptare, duke përzgjedhur ushtarët dhe nënoficerët më të aftë.

Kontingjenti shqiptar mori pjesë në stërvitjen ndërkombëtare “Cooperative Nugget 1995” në Fort Polk të

SHBA-së, ku u testua në skenarë kompleksë operacionalë. Më pas vijoi stërvitja “Peacefully Eagle ‘95” në Golem të Durrësit me trupat amerikane.

Në tetor të po atij viti, një ekip vlerësues i NATO-s testoi kontingjentin shqiptar, i cili mori vlerësimin maksimal.

Në korrik 1996, forcat shqiptare u zhvendosën në Gjermani, në brigadën franko-gjermane pranë Mynihut. Aty u zhvilluan trajnimet intensive në poligonet e qitjes, kalimet e pengesave dhe skenarët taktikë të operacioneve reale. Rezultatet e kontingjentit shqiptar surprizuan edhe vetë komandantët gjermanë. Gjeneral brigade Friedrich Riechman deklaroi: “Kolonel, me këtë rezultat që keni arritur, duhet të ngremë standardin tonë. Suksesi juaj është më shumë se befasi”. Stërvitja përfundimtare në Hamelburg simuloi situata të vërteta operative, ku çdo pjesëtar nga ushtari deri te gjenerali ishte pjesë e së njëjtës përgjegjësie.

Bosnje-Hercegovina, misioni që hapi rrugën e Shqipërisë drejt NATO-s

Më 9 shtator 1996, kontingjenti shqiptar u nis drejt Zadarit dhe më pas Sarajevës, duke u bërë pjesë e IFOR-it dhe më vonë SFOR-it.

Ishte hera e parë që Shqipëria rreshtohet përkrah aleatëve perëndimorë në një mision ndërkombëtar paqeruajtës.

Ky moment konsiderohet sot si porta hyrëse e Shqipërisë drejt NATO-s.

Forcat shqiptare operuan krah për krah me kontingjentet e Gjermanisë, SHBA-së, Francës, Kanadasë, Italisë, Turqisë, Ukrainës, Çekisë dhe Marokut.

Detyrat ishin komplekse dhe kërkonin profesionalizëm maksimal: Patrullime në zona të tensionuara. Kontroll terriroresh, Ruajtje objektsh strategjike.

Bashkëpunim operacional shumëkombësh. Sigurim i rendit dhe mbrojtjes së civilëve. Çdo veprim i kontingjentit shqiptar përfaqësonte jo vetëm misionin, por edhe imazhin e ushtrisë shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Vizitat dhe vlerësimet nga personalitete të rëndësishme si kancelari gjerman Helmut Kohl dhe presidenti francez Jacques Chirac e rritën më tej përgjegjësinë dhe motivimin e trupave shqiptare. “Çdo patrullim, çdo kontroll, çdo vendim që merrnim, ndërtonim imazhin e ushtrisë shqiptare në skenën ndërkombëtare”, kujton Gjeneral Qirjazi.

1997 - Shqipëria në krizë, kontingjenti në këmbë

Ndërsa Shqipëria përjetonte krizën dramatike të vitit 1997, kontingjenti shqiptar në Bosnjë mbeti operacional dhe i disiplinuar. Pavarësisht zhvillimeve të brendshme në vend, ushtarët shqiptarë vijuan misionin me profesionalizëm dhe seriozitet, duke fituar respektin e aleatëve ndërkombëtarë. Ky ishte një test jo vetëm ushtarak, por edhe moral.

Kontingjenti shqiptar dëshmoi se Forcat e Armatosura të Shqipërisë ishin të afta të operonin sipas standardeve të NATO-s dhe të kontribuonin në ruajtjen e paqes ndërkombëtare.

Misioni në Bosnjë nuk la pas vetëm përvojë operative. Ai la një trashëgimi historike: Shqipëria tashmë ishte pjesë e arkitekturës euroatlantike të sigurisë.

Misionet, studimet dhe dekorimet

Pas Bosnjës, gjeneral brigade (rez.) Vladimir Qirjazi mori pjesë edhe në misionet ALBA (1997) dhe AFOR/ComzonWest (1999–2000).

Në kuadër të formimit strategjik, ai kreu studime njëvjeçare në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë Amerikane (AWC), ku fitoi titullin Master në Studime Strategjike. Për kontributin e tij është dekoruar me disa vlerësime të rëndësishme, ndër to: Medalja e Nderit e Argjendtë nga Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë Medalja e NATO-s për misionet në Bosnjë-Hercegovinë.

Mesazhi për brezat e rinj të ushtarakëve

Pas dekadash në shërbim të ushtrisë dhe misioneve ndërkombëtare, mesazhi i Gjeneral Qirjazit për ushtarakët e rinj mbetet i qartë: “Shërbimi ndaj atdheut është nder, krenari dhe përgjegjësi. Suksesi në mision varet nga përgatitja paraprake, disiplina dhe besimi tek vetja dhe kolegët. Mos u lidhni kurrë për t’i mësuar situatat, por përgatituni për të reaguar me mençuri. Besimi tek kolegët tuaj është garanci për suksesin tuaj”. Historia e tij mbetet jo vetëm histori personale, por edhe pjesë e historisë moderne të Forcave të Armatosura Shqiptare, një histori që nisi në bankat e “Skënderbeut” dhe vijoi në misionet që hapën rrugën e Shqipërisë drejt NATO-s.



Motrat Qiriazhi, Gratë që Ndriçuan Arsimin dhe Zgjimin Kombëtar Shqiptar



Në historinë e kombit shqiptar ka emra që nuk janë thjesht figura të së kaluarës, por gurë themeli mbi të cilët u ngrit identiteti ynë kombëtar, kultura dhe arsimi. Ndër këto figura qëndrojnë me dinjitet të veçantë motrat Sevasti Qiriazhi dhe Parashqevi Qiriazhi, dy gra që sfiduan kohën, paragjykimet dhe vështirësitë e shekullit XIX për të hapur rrugën e dijes për vajzat shqiptare.

Më 24 maj 1891, u hodh një nga themelet më të rëndësishme të emancipimit shqiptar: themelimi i institutit të parë femëror shqiptar “Qiriazi”. Ky institucion nuk ishte vetëm një shkollë. Ai ishte një revolucion kulturor, arsimor dhe kombëtar. Në një kohë kur vajza shqiptare konsiderohej e destinuar vetëm për jetën familjare dhe kur arsimi për femrat shihej me dyshim, motrat Qiriazhi guxuan të shpallnin se kombi nuk mund të përparonte pa edukimin e grave.

Historia e tyre është histori sakrifice, idealizmi dhe patriotizmi të rrallë.

Një familje në shërbim të kombit

Familja Qiriazhi ishte ndër familjet më të njohura patriotike shqiptare të kohës së Rilindjes Kombëtare. E lindur në Manastir, Sevasti Qiriazhi u rrit në një mjedis ku gjuha shqipe dhe ndjenja kombëtare konsideroheshin mision. Vëllai i saj, Gjerasim Qiriazhi, ishte ndër figurat më aktive të arsimit dhe të përhapjes së gjuhës shqipe.

Sevastia u bë gruaja e parë shqiptare që kreu studime të larta në kolegjin amerikan për vajza në Stamboll, duke u diplomuar në vitin 1891. Ky ishte një moment historik për shqiptarët, sepse në atë kohë arsimimi i femrave shqiptare ishte pothuajse inekzistent. Pas diplomimit, ajo nuk zgjodhi një jetë të qetë personale, por u kthye në atdhe për t'i shërbyer kombit.

Në Korçë, bashkë me motrën Parashqevi dhe me mbështetjen e patriotëve shqiptarë, ajo hapi shkollën e parë shqipe për vajza, një ngjarje që shënoi fillimin e organizimit të arsimit kombëtar femëror në Shqipëri.

Shkolla e Vashave, një revolucion kombëtar

Në fundin e shekullit XIX Shqipëria ndodhej nën Perandorinë Osmane dhe arsimi në gjuhën shqipe përballej me pengesa të shumta politike e fetare. Hapja e një shkolle për vajza në gjuhën shqipe konsiderohej akt i guximshëm dhe sfidues.

Megjithatë, motrat Qiriazhi nuk u tërhoqën.

Shkolla e Vashave në Korçë u kthye shumë shpejt në simbol të emancipimit shqiptar. Aty vajzat mësonin jo vetëm shkrim e këndim, por edhe kulturë kombëtare, histori dhe ndjenjën e identitetit shqiptar. Për herë të parë, vajza shqiptare trajtohej si qytetare e ardhshme e kombit dhe jo thjesht si pjesë pasive e shoqërisë.

Kjo shkollë u përball me presione të vazhdueshme nga qarqe që kundërshtonin arsimin shqip dhe sidomos edukimin e grave. Kishte mungesë librash, mungesë fondesh dhe sulme ideologjike. Por motrat Qiriazhi vazhduan punën me një përkushtim të jashtëzakonshëm.

Në bankat e kësaj shkolle u edukuan shumë vajza që më vonë do të bëheshin mësuese, aktiviste dhe mbështetëse të çështjes kombëtare shqiptare.

Parashqevi Qiriazhi, mendja e ndritur e alfabetit shqip

Nëse Sevastia ishte organizatorja dhe drejtuesja e arsimit femëror, Parashqevi Qiriazhi u bë një nga figurat më të rëndësishme të kulturës dhe gjuhës shqipe.

Ajo mori pjesë në Kongresin e Manastirit, ku u vendos alfabeti i gjuhës shqipe. Prania e saj në këtë ngjarje historike kishte një domethënie të jashtëzakonshme: një grua shqiptare ishte pjesë aktive e vendimarrjes për fatin kulturor të kombit.

Parashqevia kontribuoi në hartimin e teksteve shkollore dhe të abetareve shqipe. Ajo besonte se gjuha ishte arma më e fortë e kombit dhe se arsimi ishte rruga drejt lirisë.

Në një kohë kur gratë në Ballkan mezi kishin të drejtë të shfaqeshin në jetën publike, motrat Qiriazhi po ndërtonin bazat e mendimit modern shqiptar.

Gruaja shqiptare dhe beteja për emancipim

Roli i motrave Qiriazhi nuk mund të kuptohet pa analizuar gjendjen e gruas shqiptare në fundin e shekullit XIX dhe

fillimin e shekullit XX.

Shumica e vajzave nuk kishin qasje në shkollim. Tradita patriarkale e kufizonte gruan brenda mureve të shtëpisë. Edukimi i saj konsiderohej i panevojshëm. Në shumë zona, vajzat marthoheshin që në moshë të vogël dhe analfabetizmi ishte i përhapur.

Në këtë realitet të vështirë, motrat Qiriazhi sollën një vizion të ri: gruaja shqiptare duhej të ishte e arsimuar, e ndërgjegjshme dhe aktive në jetën kombëtare. Kjo ide ishte revolucionare.

Përmes shkollës, shkrimeve, ligjëratave dhe kontakteve me patriotët shqiptarë brenda e jashtë vendit, ato krijuan modelin e gruas shqiptare moderne. Një grua që edukon familjen, por edhe kontribuon në shoqëri, kulturë dhe shtetformim.

Instituti “Kyrias”, vazhdimësia e misionit

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe viteve të vështira të luftërave, motrat Qiriazhi vijuan punën e tyre në arsim. Në vitet '20 ato themeluan institutin “Kyrias”, i cili u bë një nga institucionet më prestigjioze të arsimit femëror në Shqipëri.

Instituti ishte shumë më tepër se një shkollë. Ai përfaqëson frymën e qytetarisë, kulturës dhe emancipimit. Vajzat që studionin aty edukoheshin me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj familjes, shoqërisë dhe kombit.

Në këtë institucion u formuan breza të tërë vajzash shqiptare që më vonë do të kontribuonin në arsim, kulturë, administratë dhe jetën publike shqiptare.

Gratë dhe identiteti kombëtar shqiptar

Historia e motrave Qiriazhi dëshmon se pa gruan shqiptare nuk do të kishte as rilindje kombëtare të plotë dhe as zhvillim shoqëror.

Shpesh historia është shkruar duke nxjerrë në pah vetëm figurat mashkullore të kombit, por kontributi i grave shqiptare ka qenë po aq vendimtar. Nga arsimi te kultura,

nga familja te lufta për identitet, gratë shqiptare kanë qenë shtyllë e mbijetesës kombëtare.

Motrat Qiriazhi e kuptuan këtë më herët se kushdo tjetër. Ato e panë arsimin si një çështje kombëtare dhe emancipimin e grave si kusht për përparimin e Shqipërisë.

Sot, më shumë se një shekull më vonë, mesazhi i tyre mbetet aktual: një komb ecën përpara vetëm kur investon te dija dhe te edukimi i grave.

Trashëgimia që mbetet e gjallë

Veprimtaria e Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit nuk ishte vetëm një episod historik. Ajo është një trashëgimi e gjallë kombëtare.

Emrat e tyre mbajnë sot shkolla, institucione dhe rrugë. Ato kujtohen si pionieret e arsimit femëror shqiptar dhe si gra që i dhanë kombit një dimension të ri kulturor dhe qytetar.

Por nderimi më i madh për to nuk është vetëm kujtesa historike. Është vazhdimi i misionit të tyre: mbështetja e arsimit, fuqizimi i grave dhe mbrojtja e identitetit kombëtar shqiptar.

Në çdo vajzë shqiptare që sot studion, ndërton karrierë dhe kontribuon në shoqëri, jeton një pjesë e idealit të motrave Qiriazhi.

MOTRAT QIRIAZI, Gratë që ndryshuan fatin e kombit shqiptar

Më 24 maj 1891, me themelimin e institutit femëror “Qiriazi”, nisi një kapitull i ri për gruan shqiptare dhe për vetë kombin shqiptar. Sevasti dhe Parashqevi Qiriazhi nuk ndërtuan vetëm një shkollë; ato ndërtuan një vizion për Shqipërinë moderne.

Ato dëshmuan se arsimi është arma më e fuqishme e një kombi dhe se gruaja e arsimuar është themeli i qytetërimit.

Në historinë shqiptare, motrat Qiriazhi mbeten simbol i dijes, guximit dhe patriotizmit. Ato ndezën një dritë që vazhdon të ndriçojë edhe sot rrugën e arsimit dhe të emancipimit shqiptar.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Mesazhi që i mbijetoi luftës dhe që sot i duhet më shumë se kurrë njerëzimit

Nga sakrificat e një fëmije japonez tek forca morale e ushtarakut shqiptar

Në historinë e njerëzimit ekzistojnë fotografi që nuk kanë nevojë për shpjegim. Ato flasin vetë. Nuk kërkojnë koment, sepse dhimbja, sakrificat dhe madhështia njerëzore lexohen drejtpërdrejt në fytyrat dhe gjestet që ato mbartin. Një ndër këto fotografi është ajo e djaloshit japonez, i cili gjatë luftës mbante mbi shpinë trupin e pajetë të vëllait të tij për ta çuar drejt varrimit.

Në një kohë kur lufta kishte zhveshur njerëzit nga gjithçka – nga buka, nga shtëpitë, nga qetësia dhe madje edhe nga vetë jeta – ai fëmijë i vogël mbante mbi supe jo vetëm trupin e vëllait, por edhe barrën e dhimbjes njerëzore.

Një ushtar, i prekur nga pamja, i kërkoi ta linte trupin e pajetë që të mos lodhej më.

Por përgjigjja e djaloshit do të mbetej një nga mesazhet më të fuqishme morale të shekullit: **“Nuk është i rëndë... është vëllai im”**.

Kaq pak fjalë. Por aq shumë kuptim. Ato fjalë nuk flasin vetëm për dashurinë mes dy vëllezërve. Flasin për njerëzimin. Për përgjegjësinë ndaj njëri-tjetrit. Për sakrificën. Për forcën morale që lind kur njeriu zgjedh të mos e braktisë tjetrin edhe në momentet më të errëta. Dhe pikërisht për këtë arsye ajo fotografi u bë simbol i bashkimit në Japoni.

Një mesazh që sot i duhet botës më shumë se kurrë

Në kohën moderne njerëzimi ka përparuar teknologjikisht më shumë se kurrë, por shpesh duket sikur ka humbur diçka nga shpirti i solidaritetit njerëzor.

Sot njerëzit jetojnë më pranë fizikisht, por më larg shpirtërisht. Shoqëritë janë më të zhvilluara, por individit shpesh ndihet më i vetmuar. Bota prodhon më shumë pasuri, por edhe më shumë indiferencë.

Në këtë realitet, mesazhi i atij fëmije japonez tingëllon si një thirrje universale:

Mos e lini tjetrin vetëm

Sepse një komb nuk mbahet vetëm nga ekonomia, politika apo teknologjia. Një komb mbahet nga ndjenja e vëllazërisë. Nga gatishmëria për të mbajtur njëri-tjetrin kur rrëzohemi.

Ushtria dhe pesha morale e “vëllait mbi shpinë”

Për botën ushtarake ky mesazh ka një kuptim edhe më të thellë.

Ushtari mësohet të ecë në formacion, të luftojë në grup dhe të mbijetojë duke besuar tek shoku pranë tij. Në betejë nuk ekziston individualizmi. Aty jeta e secilit varet nga tjetri.

Prandaj, në ushtri, fjala “vëlla” nuk është figurë letrare. Është realitet.

Ushtari shqiptar ndër vite ka treguar pikërisht këtë frymë sakrifice: në luftëra, në misione paqeruajtëse, në operacione shpëtimi gjatë fatkeqësive natyrore dhe në çdo moment kur atdheu ka pasur nevojë.

Shumë efektivë të Forcave të Armatosura kanë mbajtur mbi supe jo vetëm pajisje e armë, por edhe jetën e shokut të tyre.

Sepse në momentet më të vështira askush nuk pyet sa e rëndë është barra. Pyetja e vetme është: **“A ka nevojë vëllai im për mua?”**.

Shqipëria ka nevojë për këtë filozofi

Shoqëria shqiptare sot ka nevojë më shumë se kurrë për rikthimin e ndjenjës së solidaritetit. Kemi nevojë të kuptojmë se askush nuk ngrihet duke shtyrë tjetrin poshtë. Askush nuk forcohet duke braktisur më të dobëtin.

Një komb bëhet i fortë kur njerëzit mbështesin njëri-

Mbi supe mbante vëllain... mbi zemër mbante njerëzimin

“NUK ËSHTË I RËNDË... ËSHTË VËLLAI IM”



tjetrin. Kur i riu respekton të moshuarin. Kur qytetari ndihmon qytetarin. Kur familja nuk shpërbëhet nga egoizmi. Kur shqiptari nuk e sheh shqiptarin tjetër si rival, por si pjesë të vetvetes. Sepse kombi është pikërisht kjo: **Një barrë që mbahet së bashku**.

“Nëse bie, do ta ngre...”. Është filozofi jetese. Është kodi moral që duhet të udhëheqë shoqëritë dhe ushtritë.

Nëse bie, do ta ngre. Nëse lodhet, do ta ndihmoj. Nëse dobësohet, do ta forcoj. Nëse largohet, do t'i afrohem. Nëse ka nevojë për mua, mbi supet e mia do ta bart.

Ky është thelbi i njerëzimit. Ky është morali që krijon kombe të forta. Ky është shpirti që i jep kuptim sakrificës së ushtarit.

Forca e vërtetë nuk është arma, por zemra

Historia ka treguar se ushtritë më të forta nuk janë

domosdoshmërisht ato me armët më moderne. Forca e vërtetë qëndron tek morali, tek besimi dhe tek lidhja mes njerëzve. Një ushtar që lufton për shokun e tij është më i fortë se çdo makineri lufte.

Një popull që nuk braktis njerëzit e vet është i pathyeshëm. Prandaj mesazhi i atij djaloshi japonez mbetet universal.

Ai nuk i përket vetëm Japonisë. Ai i përket gjithë njerëzimit. Edhe Shqipërisë.

Edhe ushtarit shqiptar.

Një moto për kohën tonë

Ndoshta bota moderne ka nevojë pikërisht për këtë moto të thjeshtë: **“Nuk është i rëndë... është vëllai im”**.

Sepse në fund të fundit, madhështia e njeriut nuk matet me atë sa mban për vete, por me atë sa është i gatshëm të mbajë për tjetrin. Dhe kombet që dinë të mbajnë njëri-tjetrin mbi supe, nuk rrëzohen kurrë.



OSFA

Tingujt e patriotizmit dhe artit ushtojnë në mbarë vendin:
Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura në një turne
artistik që bashkon muzikën, traditën dhe emocionin qytetar



Nga Shqipëria në skenat më prestigjioze të operës botërore

Në historinë e kombeve të vogla ka momente kur një artist arrin të bëhet më shumë sesa një emër i suksesshëm. Ai ose ajo shndërrohet në simbol të identitetit, kulturës dhe dinjitetit kombëtar. Për shqiptarët, një nga këto emra është sopranoja me famë botërore Ermonela Jaho, artistja që me zërin, talentin dhe shpirtin e saj ka ngritur lart emrin e Shqipërisë në skenat më prestigjioze të operës ndërkombëtare.

Nderimi i saj në Francë me titullin prestigjioz **“Chevalier des Arts et des Lettres”** përbën jo vetëm një sukses personal, por edhe një moment krenarie për kulturën shqiptare dhe për gjithë kombin shqiptar.

Ky titull, një nga dekoratat më të larta që jep Republika Franceze për personalitetet me kontribut të jashtëzakonshëm në art dhe kulturë, konfirmon atë që publiku dhe kritika ndërkombëtare kanë thënë prej vitesh: Ermonela Jaho është një nga sopranot më të mëdha të kohës sonë.

Por përtej medaljeve, duartrokitjeve dhe skenave madhështore, historia e saj është historia e forcës së talentit shqiptar, e sakrificës dhe e një vullneti që nuk njih kufij.

Një vajzë shqiptare me një ëndërr të madhe

Rruga e Ermonela Jahos drejt suksesit botëror nuk ishte e lehtë. Ajo nisi nga Shqipëria, një vend i vogël që për dekada kishte qenë i izoluar nga bota dhe ku arti shpesh mbijetonte falë pasionit dhe sakrificës së artistëve.

Që në moshë të re, Jaho tregoi një talent të rrallë për muzikën dhe operën. Zëri i saj nuk ishte vetëm teknikisht i fuqishëm, ai mbartte emocion, ndjeshmëri dhe një thellësi shpirtërore që e bënte të veçantë.

Në një kohë kur rrugët për artistët shqiptarë drejt skenave ndërkombëtare ishin të kufizuara, ajo vendosi të luftonte për ëndrrën e saj.

Dhe ia doli.

Nga Shqipëria drejt Italisë, e më pas në teatrot më të rëndësishme të botës, Ermonela Jaho ndërtoi një karrierë që sot konsiderohet ndër më të suksesshmet në historinë e operës shqiptare.

Zëri që emocionon botën

Suksesi i Ermonela Jahos nuk lidhet vetëm me teknikën vokale apo interpretimin profesional. Ajo ka arritur të krijojë një lidhje të rrallë emocionale me publikun. Kritikët ndërkombëtarë e kanë cilësuar shpesh si “artistja që këndon me shpirt” dhe “sopranoja që jeton çdo rol”. Në skenë, Jaho nuk interpreton thjesht personazhe. Ajo i jeton ato. Nga **“Madama Butterfly”** te **“La Traviata”**, nga **“Suor Angelica”** te **“Manon Lescaut”**, interpretimet e saj janë kthyer në referenca artistike për publikun dhe kritikën. Pikërisht kjo aftësi për të transmetuar emocione të vërteta ka bërë që emri i saj të duartrokitet në skenat më të mëdha të botës: Royal Opera House në Londër, Metropolitan Opera në Nju Jork, Opéra National de Paris, Teatro Real në Madrid dhe Teatro alla Scala në Milano. Në secilën prej këtyre skenave, Ermonela Jaho ka përfaqësuar jo vetëm veten, por edhe kulturën shqiptare.

Franca dhe vlerësimi i një artisteje të jashtëzakonshme

Titulli **“Chevalier des Arts et des Lettres”** është një ndër dekoratat më prestigjioze të kulturës franceze. Ai u jepet artistëve dhe intelektualëve që kanë ndikuar në zhvillimin dhe promovimin e artit dhe kulturës në nivel ndërkombëtar.

Për Ermonela Jahon, ky vlerësim ka një domethënie të veçantë. Në reagimin e saj publik, artistja e cilësoi këtë moment si një emocion të jashtëzakonshëm dhe një nder të madh personal e artistik. **“Marrja sot e titullit ‘Chevalier des Arts et des Lettres’ është për mua një emocion i jashtëzakonshëm dhe një nder shumë i dashur për zemrën time, aq më tepër sepse Franca përfaqëson për mua dashurinë për artin, kulturën dhe të vërtetën njerëzore”**, u shpreh ajo.

Artistja shqiptare shprehu gjithashtu mirënjohje ndaj Francës për mënyrën sesi ka mirëpritur artin dhe personalitetin e saj. “E marr këtë dekoratë me përlulesi, mirënjohje dhe emocion të thellë. Faleminderit Francë që e mirëprite zërin dhe zemrën time me kaq bujari”, deklaroi ajo.

Arti shqiptar si ambasador i kombit

Suksesi i Ermonela Jahos është dëshmi se arti është një nga format më të fuqishme të përfaqësimit kombëtar. Në shumë raste, artistët bëhen ambasadorët më të mirë të një vendi. Ata ndërtojnë ura kulturore, krijojnë respekt dhe

ERMONELA JAHO ZËRI SHQIPTAR QË PUSHTOI BOTËN



i japin një kombi identitet në arenën ndërkombëtare. Kjo është ajo që ka bërë Ermonela Jaho për Shqipërinë. Në çdo skenë ku ka interpretuar, ajo ka treguar se shqiptarët nuk janë vetëm histori vuajtjesh apo tranzicioni, por edhe popull me kulturë të pasur, talent të jashtëzakonshëm dhe shpirt artistik të rrallë. Në një botë ku konkurrenca artistike është e jashtëzakonshme, një artiste shqiptare ka arritur të renditet mes emrave më të mëdhenj të operës botërore.

Ky nuk është vetëm sukses individual. Është sukses kombëtar.

Forca e shqiptarëve përmes talentit

Historia e shqiptarëve ka qenë shpesh histori mbijetese, sakrifice dhe përpjekjeje për t'u afirmuar në botë. Por pikërisht nga këto vështirësi kanë lindur figura që kanë arritur të sfidojnë kufijtë dhe paragjykimet. Ermonela Jaho është një prej tyre. Ajo mishëron forcën e karakterit shqiptar, përkushtimin ndaj punës dhe aftësinë për të arritur majat botërore pa humbur thjeshtësinë dhe identitetin. Suksesi i saj është një mesazh frymëzimi për brezat e rinj shqiptarë:

Talenti nuk njih kufij kur shoqërohet me punë, disiplinë dhe besim, historia e Jahos dëshmon se shqiptarët mund të jenë konkurrues dhe fitues në çdo skenë ndërkombëtare.

Një zë që mbetet krenari kombëtare

Ermonela Jaho nuk është vetëm një soprano e famshme. Ajo është simbol i artit shqiptar modern dhe një nga figurat që i ka dhënë Shqipërisë respekt në arenën kulturore botërore. Çdo sukses i saj është një kujtesë se kombet nuk bëhen të mëdha vetëm nga fuqia ekonomike apo ushtarake, por edhe nga kultura, arti dhe njerëzit që i japin zë identitetit të tyre. Në skenat më prestigjioze të botës, mes dritave, orkestrave dhe duartrokitjeve, vazhdon të dëgjohet edhe zëri i Shqipërisë.

Dhe ky zë ka emrin Ermonela Jaho.

Dekorimi i Ermonela Jahos me titullin **“Chevalier des Arts et des Lettres”** është një moment historik për kulturën shqiptare dhe një dëshmi e fuqisë së talentit shqiptar në botë.

Ajo ka treguar se arti shqiptar mund të arrijë majat më të larta ndërkombëtare dhe se një artiste nga Shqipëria mund të bëhet pjesë e elitës botërore të operës. Por mbi të gjitha, Ermonela Jaho ka dëshmuar se talenti shqiptar mbetet një nga pasuritë më të mëdha të kombit.

Një pasuri që nuk njih kufij, nuk ndalet nga vështirësitë dhe që vazhdon ta bëjë Shqipërinë krenare në sytë e botës.

Nga sulmet kibernetike të vitit 2022 tek integrimi në qendrën më të madhe të NATO-s për mbrojtjen digjitale

Shqipëria ka hyrë zyrtarisht në NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE), duke u bërë pjesë e një prej strukturave më të rëndësishme të Aleancës për sigurinë kibernetike. Ky anëtarësim jo vetëm që rrit kapacitetet mbrojtëse të vendit, por e pozicionon Shqipërinë si një aktor aktiv në arkitekturën e sigurisë digjitale të NATO-s dhe Europës.

Në një ceremoni solemne në selinë e NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE) në Tallinn, u ngritën flamujt e tre shteteve të reja anëtare: Shqipëria, Finlanda dhe Suedia. Ky moment shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e mbrojtjes kibernetike kolektive të Aleancës dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë strategjike.

Çfarë është NATO CCDCOE?

CCDCOE u themelua në vitin 2008 në Tallinn, Estoni, si një iniciativë për të forcuar kapacitetet e Aleancës në fushën e mbrojtjes kibernetike. Sot, ajo është qendra më e madhe e akredituar nga NATO në këtë fushë, duke bashkuar 39 vende anëtare dhe partnere.

Qendra vepron si një platformë e integruar me fusha të ndryshme, duke mbuluar katër fusha kryesore:

- Strategjike: zhvillimi i politikave dhe doktrinae të mbrojtjes kibernetike.
- Ligjore: interpretimi i ligjit ndërkombëtar në kontekstin e konflikteve digjitale (p.sh. Tallinn Manual).
- Operative: koordinimi i stërvitjeve dhe simulimeve të sulmeve kibernetike.
- Teknike: zhvillimi i zgjidhjeve praktike dhe inovative për mbrojtjen e rrjeteve.

CCDCOE organizon ushtrime të nivelit botëror, si Locked Shields – stërvitja më e madhe e mbrojtjes kibernetike në botë, ku simulohet mbrojtja e infrastrukturave kritike kundër sulmeve masive. Gjithashtu, qendra publikon studime dhe manuale që janë bërë referenca globale, si Tallinn Manual, i cili përcakton se si ligji ndërkombëtar zbatohet në konfliktet kibernetike.

Pse Shqipëria ka nevojë për këtë anëtarësim?

Sulmet e vitit 2022

Në vitin 2022, Shqipëria u përball me sulme masive kibernetike që paralizuan shërbimet publike dhe infrastrukturën digjitale. Ky ishte një alarm i fortë për vendin, duke treguar se siguria kibernetike nuk është më një luks, por një domosdoshmëri.

Integrimi në NATO CCDCOE

Anëtarësimi në CCDCOE i jep Shqipërisë:

- Akses në ekspertizën më të avancuar të NATO-s.
- Mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve kombëtare.
- Pjesëmarrje në trajnime dhe ushtrime ndërkombëtare.
- Shkëmbim njohurish dhe teknologjish me vendet më të zhvilluara.

Përfitimet për Shqipërinë

1. Siguria kombëtare

CCDCOE do të ndihmojë Shqipërinë të ndërtojë një mbrojtje të fortë digjitale, duke parandaluar sulme të ngjashme me ato të vitit 2022.

2. Rezistencë kibernetike

Institucionet publike dhe private do të përfitojnë nga standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke siguruar që shërbimet jetike të vazhdojnë të funksionojnë edhe në rast krizash.

3. Bashkëpunim ndërkombëtar

Shqipëria bëhet pjesë e një rrjeti ku ekspertët e vendeve anëtare ndajnë përvoja dhe teknologji. Ky bashkëpunim rrit kapacitetin e vendit për të reaguar ndaj kërcënimeve globale.

4. Ekonomi dhe investime

Një vend me siguri të lartë kibernetike është më tërheqës për investitorët e huaj. Anëtarësimi rrit besueshmërinë e Shqipërisë si destinacion për bizneset digjitale.

5. Zhvillimi i burimeve njerëzore

Ekspertët shqiptarë të IT-së dhe sigurisë do të kenë mundësi të marrin pjesë në programe trajnimi dhe kërkime të avancuara, duke rritur nivelin profesional të burimeve njerëzore në vend.

6. Roli strategjik në rajon

Shqipëria, si pjesë e CCDCOE, jo vetëm që forcon sigurinë e saj, por edhe kontribuon në stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, duke u pozicionuar si një aktor kyç në arkitekturën e sigurisë europiane dhe transatlantike.

Dimensioni politik dhe diplomatik

Ky anëtarësim nuk është thjesht teknik, por edhe politik.



Shqipëria bëhet pjesë e NATO CCDCOE: Një hap historik drejt forcimit të sigurisë kibernetike

Shqipëria tregon se është e gatshme të marrë përgjegjësi në kuadër të NATO-s dhe të kontribuojë në fushën e sigurisë digjitale. Kjo e rrit profilin e vendit në arenën ndërkombëtare dhe e bën atë një partner më të besueshëm. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO CCDCOE është një hap historik që shkon

përtej teknologjisë. Ai përfaqëson një garanci për sigurinë kombëtare, një mundësi për zhvillim ekonomik dhe një rol më të madh në bashkëpunimin ndërkombëtar. Shqipëria jo vetëm që përfiton nga ekspertiza e Aleancës, por edhe kontribuon në ndërtimin e një bote më të sigurt digjitalisht.





Qendra e Personel Rekrutimit njofton se do të rekrutojë **1 (një)** kandidat për studime në Qendrën e Studimeve Universitare në Kosovë, për vitin akademik **2026–2027**.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është **29 maj 2026**.

Për informacion kontaktoni:

Telefon: **00355 42 348 588**

WhatsApp: **+355 68 340 4896**

Informacion i plotë:

<https://www.mod.gov.al/newsroom/njoftime/studente-brenda-jashte-vendit/7789-qendra-e-personel-rekrutimit-do-te-rekrutoje-1-nje-kandidat-per-studime-ne-qendren-e-studimeve-universitare-ne-kosove>